



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 186 prot.

Tiranë, më 27.01.2026

URDHËR

NR. 17 Datë 27.01 2026

“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS
NË ISHPSHSH”

Në mbështetje të nenit 6, të Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 295, datë 20.3.2013, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, si dhe Urdhërit nr. 280, datë 30.12.2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për Autoritetet Publike”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit model të Transparencës për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH), sipas formës dhe përmbajtjes së miratuar me Urdhërin nr. 280, datë 30.12.2025 nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Programi i Transparencës së ISHPSHSH-së ka përmbajtjen sipas lidhjes 1, bashkëlidhur dhe publikohet në faqen zyrtare www.inspektoriatipunes.gov.al, në menunë “Programi i Transparencës”.
3. Ngarkohen të gjitha drejtoritë në nivel qendror dhe rajonal, si dhe koordinatori për të drejtën e informimit, për të bashkërenduar punën për bërjen publike sa herë që është e domosdoshme të çdo dokumenti në funksion të programit model të transparencës.
4. Programi i Transparencës së ISHPSHSH-së miratuar me Urdhërin nr. 132 prot., datë 22.06.2022 shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTOR

Eljo Muçaj

